



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 3079 prot.

Tiranë më, 20.11.2018

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 06, datë 20. 11. 2018

PËR HETIMIN PASUROR, SEKUESTRIMIN DHE KONFISKIMIN E PRODUKTEVE TË VEPRËS PENALE

Në mbështetje të nenit 148/b shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 38 pika 2, shkronja “b”, 46 pikat, 1, 2, 3, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neneve 3, 6, 38 të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar, Trafikimit, Korruptionit dhe Krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, neneve 28, 29, 210, 274 e vijues të ligjit nr.7905, datë 23.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 36 e vijues të ligjit nr.7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Me synim, unifikimin e zbatimit të ligjit¹ kundër pasurisë së personave të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin dhe korruptionin, etj, si dhe për forcimin e ligjshmërisë dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale,

UDHËZOJ:

Neni 1

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda (në vijim PKR) ngrihet dhe funksionon seksioni i posaçëm² për kryerjen e hetimit pasuror kundër pasurisë

¹ Shih, ligjin nr.10192/2009, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017, hyrë në fuqi më datë 21.06.2017.

² Shih, po aty, nenin 38 “Dispozita kalimtare” pikat 2, 3, 4 që parashikojnë:

“2. Për procedimet pasurore në fazën e hetimit, ky ligj fillon të zbatohet me hyrjen e tij në fuqi.

3. Për pasuritë e vëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë lidhje me veprat penale të reja që shtohen në nenin 3, pika 1, të tij, zbatohen parashikimet e pikës 6, të nenit 3, të këtij ligji.

së personave, të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar, trafikimin dhe korruptionin, si dhe për kryerjen e kimeve të tjera, që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe kimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”³, i ndryshuar.

Neni 2

1. Prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të këtij seksioni, nëpërmjet burimeve të ndryshme, të hapura ose jo (mediat, zyrat e prokurorive, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Shërbimi Informativ Shtetëror, etj.), sipas rastit, menjëherë, por jo më vonë se brenda një afati dy mënyra nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, identifikojnë subjektet (shtetasit shqiptarë ose të huaj me banim në Shqipëri), për të cilët ka dënlime të formës së prerë, ka patur hetime apo ka aktualisht hetime brenda ose jashtë vendit, apo ka indicie të besueshme për pjesëmarrje në veprimtari kriminale, për veprat penale të përcaktuara në nenin 1 të këtij udhëzimi.

4. Deri në krijimin e gjykates kundër korruptionit dhe krimit të organizuar, çështjet për marrjen e masave parandaluese kundër pasurisë do të gjykohen nga Gjykata për Krimet e Rënda.”

³ Shih, po aty nenin 3 “Fusha e veprimit” në të cilin parashikohet se:

“ 1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje dhe kryerje të kimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupei strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;

b) pjesëmarrje dhe kryerje e kimeve nga organizata terroriste dhe kimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e kimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;

ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

d) kryerjen e kimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/I, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/q, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përvçe kur provohet e kundërtë;

b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjafshesme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshëmin e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënat e mjafshesme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshëmin e origjinës së pasurisë.

5. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekti i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përparrë hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicie të rëndësishme për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.”

2. Me marrjen dijeni se pranë një prokurorie tjetër ka akte/dokumente, të llojit/natyrës sipas nenit 1 të këtij udhëzimi, njoftojnë pa vonesë atë prokurori, duke i kërkuar dërgimin⁴ e kopjeve të akteve përkatëse.

Neni 3

1. Prokuroritë e shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm, sipas rastit, menjëherë, por jo më vonë se brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, duhet të kalojnë kopje të akteve/dokumenteve përkatës ose të dërgojnë informacion në PKR, në lidhje me subjektet që kanë patur në hetim dhe/ose kanë përfunduar hetimet, si në rastet kur janë dërguar për gjykim, ashtu dhe në rastet kur është vendosur pushimi i hetimeve, për veprat penale të përcaktuara në nenin 7 të këtij udhëzimi.

2. Informacioni duhet të përmbyajë: -të dhëna për subjektin, -të dhëna për veprën apo veprat penale dhe -të dhëna për mënyrën e përfundimit të procedimit penal ndaj subjektit, të shoqëruara me aktet proceduriale dhe/ose dokumentet përkatëse.

Neni 4

1. Drejtoria e Marrëdhënieve Juridikionale me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sipas rastit, menjëherë, por jo më vonë se brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, duhet të dërgojë informacion dhe aktet/dokumentet përkatëse në PKR në lidhje me subjektet⁵, për të cilat është bërë njohja e vendimit penal të huaj apo është kryer ekstradimi, për veprat penale të përcaktuara në nenin 1 të këtij udhëzimi.

2. Informacioni duhet të përmbyajë: -të dhëna për subjektin, -të dhëna për veprën apo veprat penale për të cilat është dënuar dhe -të dhënat e vendimeve gjyqësore në zbatim të cilëve subjekti ka vuajtur apo po vuan dënimin ose është ektraduar.

Neni 5

Prokurorët e seksionit të posaçëm, nën mbikëqyrjen e drejtuesit të Prokurorisë për Krimë të Rënda, brenda një muaji nga administrimi i informacioneve të mësipërme, pasqyrojnë në një regjistër të veçantë, të dhënat për çdo subjekt dhe vlerësojnë e vendosin fillimin e hetimit pasuror për ato subjekte që përcaktohen në nenin 3 të ligjit “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe krimeve të tjera, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”⁶, i ndryshuar.

⁴ Shih, nenin 29 të K.Pr.Penale;

⁵ Shih, nenin 3 “Fusha e veprimit” ligji nr.10192/2009 i ndryshuar.

⁶ Shih, po aty nenin 3 “Fusha e veprimit” në të cilin parashikohet se:

“ 1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtë/drejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij nenit, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;

b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimete për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;

Neni 6

Në PKR hetimi kundër pasurisë së subjekteve⁷ të ligjit, për çdo rast në vijim, do të kryhet nga prokurori që ka në hetim çështjen penale në kompetencën lëndore të asaj prokurorie. Kur nga hetimi pasuror arrihet në konkluzionin se duhet të procedohet me vendosjen e masës së sekuestros, kundrejt relacionit të arsyetuar, prokurori i cështjes ia kalon materialet seksionit të posaçëm.

Neni 7

1. Në prokuroritë e shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm, si dhe në Prokurorinë për Krime të Rënda, për çdo rast të regjistrimit të procedimeve penale për veprat penale të parashikuara nga nenet: 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/e, 319/dh, 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 283, 283/a, 284/a dhe 287 të Kodit Penal, kur hetohet për pjesëmarrje dhe kryerje të kimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal, si dhe kur hetohet për pjesëmarje dhe kryerje të kimeve nga organizata terroriste dhe kimeve për qëllime terroriste, të fillojë menjëherë verifikimi pasuror i subjekteve⁸ përkatëse, në kuadër të hetimeve që kryhen në procesin penal.

c) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

d) kryerjen e kimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicë përfitimit pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përvëse kur provohet e kundërta;

b) personat fizik ose juridik, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën "a", të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën "b", të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

5. Masat parandaluese mund të kërkohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë indicë të rëndësishme përfshirjen e tyre në veprimtar kriminale, në kohën e vënies së pasurisë.⁹

⁷ Shih, po aty nenin 3 "Fusha e veprimit" ligji nr.10192/2009 i ndryshuar.

⁸ Shih, po aty nenin 3.

2. Objekt i verifikimeve janë mjetet financiare, pasuritë, veprimtaritë ekonomike, tregtare dhe profesionale, niveli ekonomik, si dhe burimi i të ardhurave të këtyre subjekteve.

3. Verifikimet kryhen në të gjitha institucionet publike dhe private duke përfshirë, por jo vetëm: Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat, QKB, QKL, DSHTRR, DRTT, Drejtoria e Doganave, ALUIZNI, Kapiteneria e Porteve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit etj. Kur lind nevoja për ndihmë juridike ndërkontaktore, zbatohen marrëveshtjet ndërkontaktore, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe dispozitat përkatëse proceduriale.

4. Në përfundim të verifikimeve, në ato raste kur rezultojnë të dhëna për pasuri të vëna nga aktiviteti kriminal, prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm, dërgojnë menjëherë në PKR një relacion shpjegues bashkë me aktet hetimore të administruara.

5. Në raste të evidentimit të pasurive kriminale, të vlerësohet dhe vendoset kryerja e sekuestrit sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Penale⁹ dhe menjëherë të njoftohet PKR, duke vendosur kalimin e kopjes së akteve sipas nenit 3 të këtij udhëzimi.

6. Lidhur me llogaritë bankare, për të garantuar sekuestrimin në kohë dhe për të shmangur tjetërsimin apo humbjen e tyre, prokurori të shfrytëzojë parashikimet e nenit 210 të Kodit të Procedurës Penale, për të bërë të mundur blokimin e depozitave bankare apo llogarive rrjedhëse.

Neni 8

Prokurorët e seksionit të hetimit pasuror, në çdo hetim pasuror duhet të bashkërendojnë veprimet e tyre me ato të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm dhe/ose me prokurorët e PKR për veprat penale të parashikuara nga ky ligji¹⁰, me qëllim grumbullimin dhe administrimin e të gjitha të dhënave akteve/ dokumenteve të nevojshme.

Neni 9

1. Në çdo rast të hetimit të veprave penale, nga të cilat ka dyshime të asyeshme të bazuara në prova se ka ardhur produkti kriminal, prokurori duhet të kryejë hetime financiare, të vlerësojë dhe kërkojë në gjykatë sekuestro preventive të produkteve të veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që ligji penal¹¹ lejon të konfiskohet.

2. Në përfundim të hetimeve të çështjeve penale, për të cilat është kërkuar sekuestro preventive, sipas paragrafit të parë të këtij neni, sipas rastit, prokurori i prokurorisë pranë gjykatës të shkallës së parë të juridikSIONIT të përgjithshëm ose prokurori i PKR që ndjek procedimin penal, për mënyrën e përfundimit të hetimeve paraprake, njofton menjëherë seksionin e hetimit pasuror pranë PKR.

⁹ Shih, nenet 274 e vijues të K.Pr.Penale.

¹⁰ Shih, ligjin nr.10192/2009 i ndryshuar

¹¹ Shih, nenin 36 të K.Penal dhe nenin 274 e vijues të K.Pr.Penale.

Neni 10

Në përfundim të gjykimit të çështjeve penale, prej të cilave është përfshuar produkt kriminal, të kërkohet në gjykatë konfiskimi i produkteve të veprës penale apo të çdo pasurie, vlera e së cilës i korrespondon asaj të produkteve të veprës penale, sipas përcaktimeve të nenit 36 të Kodit Penal.

Neni 11

PKR mban regjistër të veçantë për procedimet pasurore, në përpunhje me formatin e miratuar me Urdhrin nr.165, datë 24.07.2017 të Prokurorit të Përgjithshëm, ku pasqyrohen të gjitha të dhënat nga momenti i regjistrimit deri në përfundim të procedimit pasuror.

Neni 12

1. Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksim të përgjithshëm mbajnë regjistër të veçantë për rastet e njoftimit të PKR në lidhje me nisjen e hetimit pasuror, si dhe për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale.

2. Treguesit në regjistër duhet të përmbajnë: -të dhëna për subjektin dhe rrëthin e subjekteve për të cilët janë kryer verifikime të pasurisë, -të dhëna për veprën apo veprat penale dhe -të dhëna për pasuritë objekt hetimi, sekuestrimin, konfiskimin etj.

Neni 13

Prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksim të përgjithshëm dhe PKR, raportojnë periodikisht në Sektorin e Statistikës pranë Prokurorisë së Përgjithshme brenda datës 10, të muajve janar, prill, korrik e tetor, përkatësisht për periudhat vjetore, 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore, të dhënat statistikore progresive sipas formatit bashkëlidhur.

Neni 14

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm¹² për zbatim nga drejtuesit e prokurorive, prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore pranë tyre dhe personeli i prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksimit të përgjithshëm dhe PKR.

2. Me monitorimin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksimit të përgjithshëm dhe të PKR, si dhe prokurori i caktuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

3. Drejtuesit e prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme¹³ për lehtësimin e zbatimit të këtij udhëzimi.

¹² Shih po aty nenin 46 pika 1;

¹³ Shih po aty nenin 46 pika 4;

Neni 15

1. Ky udhëzim do jetë në fuqi deri në krijimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Posacme Kundër Korruptionit dhe Krimtit të Organizuar.

2. Me fillimin e funksionimit kësaj Prokurorie, hetimet pasurore dhe kërkesa për marrjen e masave parandaluese sipas ligjit¹⁴, kryhen në shkallë të parë, nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksim të përgjithshëm ose nga Prokuroria e Posacme, në bazë të kompetencës përkatëse lëndore për veprën penale të kryer¹⁵.

Neni 16

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet¹⁶ në faqen zyrtare të Prokurorisë Përgjithshme.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet çdo akt i mëparshëm që bie në kundërshtim me të.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM



¹⁴ Shih, ligjin nr.10192/2009, i ndryshuar me ligjin nr. 70/2017, datë 27.4.2017.

¹⁵ Shih, po aty nenin 7 të ligjit nr.10192/2009 i ndryshuar dhe nenin 75/a e vijues të K.Pr.Penale.

¹⁶ Shih po aty nenin 46 pikë 5;

STATISTIKA E SEKUESTRIMEVE

STATISTIKA E SEKUESTRIMEVE

STATISTIKA PROCESI ANTIMAFIA

STATISTIKA PROCESI ANTIMAFIA

kesh ose illogari re(vlera në lekë)	Sende të luajshme	Sende të patluajshme	Aktivitet tregtarë	Vendimi gjykates Sh.I per konfiskimin	Vendim gjykates Apelit per konfiskimin
500.001- 5.000.000	mbi 5.000.000	Automjete	Sende te cmuara	Apartamente/ndertesa deri 100 m ²	
32	33 34	35		Apartamente/ndertesa mbi 100 m ²	
		36		Toke deri 500 m ²	
		37 38	39	Toke mbi 500 m ²	Person fizik
			40	Sh.p.k	
			41 42	sha	
			43	Pranuar teresisht/konfiskuar	
			44	Pranuar pjeserisht	
			45 46	Rrezuar Lene ne fuqi V.Gj.Sh.I	
			47	Ndryshuar	
			48	Pushuar	
			49	Rigjykim	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA GJYQËSORE

Nr. 3049 Prot./A.Xh

Tiranë, më 20. 11. 2018

Lënda : Dërgohet Udhëzim i Përgjithshëm.

Drejtuar :

PROKURORISË SË RRETHIT GJYQËSOR

**PROKURORISË PËR KRIME TË RËNDA
TIRANË**

PROKURORISË SË APELIT

**PROKURORISË SË APELIT PËR KRIME TË RËNDA
TIRANË**

**DREJTORIVE DHE SEKTORËVE
KËTU**

Bashkëlidhur ju dërgojmë Udhëzimin e Përgjithshëm me nr. 6, datë 20.11.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm “Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, si dhe tabelat përkatëse.

Faleminderit për mirëkuptimin,

